



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2021:281053

Datë: 02.02.2022

Numri i dokumentit: 02669614

P.nr.02/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA KAÇANIK, Gjyqtari Burim Çaka me procesmbajtësen Suzane Rudi, në çështjen penale kundër të pandehurit A.L, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 lidhur me nenin 1 nën paragrafin 1.4 të KPRK-së, sipas aktakuzës me numër PP/II.nr.1887/2021 të datës 05.01.2022 dhe veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 lidhur me nenin 1 nën paragrafin 1.4 të KPRK-së, sipas aktakuzës me numër PP/II.nr.1216/2021 të datës 27.09.2021. pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, publik më datë 12.01.2022, në praninë e Prokurores së Shtetit Luljeta Bilalli, të pandehurit, mbrojtësit sipas detyrës zyrtare Avokat Ngadhujim Rudi dhe palëve të dëmtuara G.L dhe XH.L, me datë 13.01.2021 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më datë **02.02.2022** përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: A.L nga fshati ... Komuna e Kaçanikut, i lindur me datë ..., nga i ati H... e ëma M... e gjinisë Sh..., i martuar, prind i 4 fëmijëve, me numër personal ..., ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendej në masën e paraburgimit nga data 13.12.2021 deri me datë 12.01.2022.

ËSHTË FAJTOR

I. Me datë 10.12.2021, rreth orës 18:30 minuta, në fshatin ... Komuna e Kaçanikut, saktësisht në shtëpinë e tyre, i pandehuri me dashje ka përdorur forcën fizike ndaj viktimës së ndjeshme-vajza e tij të mitur G.L, në atë mënyrë që pasi i pandehuri kishte kuptuar se G...kishte probleme në shkollë me dy persona nxënës të shkollës së mesme, fillimisht e kishte qortuar e me pas e kishte sulmuar të dëmtuarën, duke e goditur me dorë dy herë në fytyrë, me cilin veprim i shkakton lëndime të lehta trupore, me dëmtim të përkohshme për shëndetin.

- Me këto veprime ka kryer veprën penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1. lidhur me nenin 1 nën paragrafin 1.4 të KPRK-së.

II. Me datë 05.08.2021, rreth orës 12:00h në shtëpinë e tyre të përbashkët në fshatin ... Komuna e Kaçanikut, i pandehuri me dashje ka përdor forcën fizike ndaj viktimës së ndjeshme-bashkëshortes së tij XH.L, në atë mënyrë pas një mosmarrëveshje në mes tyre për shkak se i pandehuri po i qortonte fëmijët dhe në momentin që e dëmtuara e kundërshton i pandehuri fillimisht e kishte sulmuar fizikisht duke e goditur me duar në pjese të ndryshme të trupit, e me pas merr një (tëhollus nga druri)-mjet ky i përshtatshëm për shkaktimin e lëndimeve të rënda trupore apo dëmtimin e rëndë për shëndetin dhe e godet njëherë në këmbën e djathtë, me të cilat veprime të dëmtuarës i shkakton lëndime të lehta trupore, me dëmtim të përkohshme për shëndetin.

- Me këto veprime ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 lidhur me nenin 1 nën paragrafin 1.4 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit lartcekur dhe neneve 2, 17, 38, 39, 42, 69, 70, 71 dhe 72, 76 të KPRK-së, 359, 360, 361 dhe 365 të KPPK-së, i:

CAKTON

Për veprën penale nga pika I e dispozitivit, i cakton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90 (Nëntëdhjetë ditëve)

Për veprën penale nga pika II e dispozitivit i cakton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 ditëve (Njëqind e tetëdhjetë ditëve)

Konform nenit 76 par 1 dhe 2 pika 2.2 dhe 2.4 të KPRK-së, gjykata të pandehurin e:

GJYKON

1. Me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 8 muajve (Tetë muajve), i cili do të ekzekutohet në afat prej 15 ditëve prej plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në dënimin e shqiptuar i llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data 13.12.2021 deri më datë 12.01.2022
2. Palët e dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil
3. Detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaje shumën prej 60,00€, si dhe për Fondin për Kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej 30€ të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Ferizaj ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1887/2021 të datës 05.01.2022 kundër të pandehurit të lartë shënuar për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të KPRK-së dhe aktakuzës PP/II.nr.1216/2021 të datës 27.09.2021. kundër të pandehurit të lartë shënuar për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 të KPRK-së, duke propozuar që të pandehurin ta shpall fajtor dhe t'i shqiptohet sanksioni penal konform ligjit në fuqi.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më datë 12.01.2021.

Gjykata konform nenit 35 të KPPK-së dhe me pëlqimin e palëve i bashkoi lëndët sipas aktakuzave PP/II.nr.1887/2021 të datës 05.01.2022 me numër P.nr.02/22 dhe lëndën sipas aktakuzës PP/II.nr.1216/2021 të datës 27.09.2021 me numër të lëndës P.nr.265/21 dhe ka vendosur që procedura të udhëhiqet sipas numrit të lëndës P.nr.02/22.

Prokurorja e shtetit pas leximit të aktakuzës PP/II.nr.1216/2021 të datës 27.09.2021 ka bërë përmirësimin e dispozitivit të aktakuzës edhe atë në datën e kryerjes së veprës penale pasi që gabimisht është shënuar dhe data e kryerjes së veprës penale është 05.08.2021.

Në këtë seancë pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit të aktakuzave më numër PP/II.nr.1599/2021 të datës 09.12.2021 dhe PP/II.nr.1216/2021 të datë 27.09.2021 i pandehuri e pranoi fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, ka theksuar se është penduar për rastin e ndodhur, i ka kërkuar falje palëve të dëmtuara dhe i ka premtuar gjykatës se nuk do të përsëris veprime të njëjta në të ardhmen.

Mbrojtësi i të pandehurit Avokat Ngadhnjim Rudi lidhur me pranimin e fajësisë ka deklaruar se pas konsultimeve dhe pas sqarimit të benificioneve dhe pasojave të pranimit të fajësisë e pranon fajësinë për veprat penale të cilat i vihen në barrë, dhe me qenëse i mbrojturi im e ka pranuar fajësinë në këtë fazë të procedurës për veprat penale të cilat i vihen në barrë kërkojmë nga gjykata të këtë parasysh fakt-pranimin e fajësisë, sjelljen e mirë të të mbrojturit tim gjatë procedurës penale, gatishmërinë e tij për të bashkëpunuar, rregullimin e marrëdhënieve- raporteve familjare, pendimin si dhe premtimin se nuk do të përsërit vepra në të ardhmen e po ashtu kërkojmë nga gjykata që të merret për bazë edhe gjendja shëndetësore duke e pasur parasysh faktin se i njëjti pas aksidentit të cilin e ka pasur i njëjti vuan nga pasoja neurologjike-defektin trunorë minimal pos operativ sipas ekzaminimit të datës 11.06..2019 ashtu që me rastin e shqiptimit të dënimit të mbrojturit tim të i shqiptohet një dënim sa më i butë më të cilin do të arrihej efekti pozitiv i sanksionimit.

Prokurorja e Shtetit duke shprehur mendimin e sajë lidhur me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë së të pandehurit, ngase e njëjta është bërë konform nenit 248 të KPP-së dhe këtë pranim të fajësisë i akuzuari e ka bërë me vullnetin e tijë pas

konsultës me mbrojtësin e tij dhe sipas provave që e mbështesin të dy aktakuzat i ka propozuar gjykatës që të marrë aktvendim me të cilin do të bëhet pranimin i fajësisë nga i akuzuari dhe gjatë shqiptimit të dënimit të këtë parasysh si rrethanë lehtësuese vetëm pranimin e fajësisë nga i akuzuari ndërsa si rrethanë rënduese të ketë parasysh në të dy rastet se vepra penale në të dy rastet është kryer brenda marrëdhënieve familjare edhe atë në periudhë të shkurtër kohore është përsëritur vepra penale ku këto vepra penale janë kryer ndaj viktimave të ndejshmeje për faktin në rastin ku bashkëshortja është e dëmtuar ku përpos marrëdhënies në këtë rast kemi varësi në raport me kryerësin pasi që e njëjta ka qenë e pa papunësuar e gjendja e saj e ka bërë që në raport me kryerësin të jetë e frikësuar kurse i akuzuari edhe pse kishte këtë rast me bashkëshorten kishte vazhduar dhunën ndaj vajzës së tijë të mitur e cila konsiderohet viktimë e ndjeshme për faktin e marrëdhënies, varësisë dhe moshës së mitur dhe për faktin të akuzuarit ishin besuar fëmijët nga bashkëshortja pas ndarjes së tyre e cila nuk ishte duke jetuar së bashku me të akuzuarin dhe fëmijët e gjithashtu i akuzuari përveç këtyre vë dy rasteve nga verifikimi i të kaluarës kriminale ka edhe raste të tjera penale të natyrës së njëjtë si në aktakuzë por ka edhe rast të armë mbajtjes pa leje, Narkotikëve, Mashtrim etj raste, të gjitha këto rrethana gjykata të i ketë parasysh gjatë shqiptimit të dënimit se në rastin konkretë kemi të bëjmë më një recidivist të veprave penale e qëllimi i dënimit me një dënim meritor ndaj këtij të akuzuari do të ishte një preventiv për parandalimin e përsëritjes së veprës penale e mbi të gjithave siguri e familjes së tijë në këtë rast.

Pala e dëmtuar XH.L për vetën e sajë dhe për vajzën e sajë të mitur ka deklaruar se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk parashtrohet kërkesë pasurore juridike.

Pasi që i pandehuri e ka pranuar fajësinë gjatë shqyrtimit fillestar, gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par 1 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se: I pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit; Pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokuroria e Shtetit të cilat gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto prova të mbledhura gjatë procedurës hetimore; Akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurve ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të dy veprave penale: Lëndim i lehtë trupor nga neni

185 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 lidhur me nenin 1 nën paragrafin 1.4 të KPRK-së, dhe veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 lidhur me nenin 1 nën paragrafin 1.4 të KPRK-së, në mënyrë kohë dhe vend si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata sipas detyrës zyrtare rikualifikoi veprat penale: Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1, në veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 lidhur me nenin 1 nën paragrafin 1.4 të KPRK-së; dhe veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2, në veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 lidhur me nenin 1 nën paragrafin 1.4 të KPRK-së, sepse Gjykata ka vlerësuar se kualifikimi juridik i veprave penale ka qenë jo i plotë dhe si të tilla i ka ri kualifikuar duke u bazuar në natyrën e lëndimeve të palëve të dëmtuara të cilat sipas vlerësimit të ekspertëve kanë pësuar këndime të përkohshme të shëndetit. Me rastin e rikualifikimit gjykata ka vlerësuar se rikualifikimi nuk është bërë në dëm të palës së akuzuar.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurit, gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 69, 70 të KPRK-së, dhe për të pandehurin A.L gjeti si rrethanë posaçërisht lehtësuese se i pandehurit e ka pranuar fajësinë, se është pënduar për veprën penale dhe i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tjera penale, kërkim faljen palëve të dëmtuara si dhe rregullimin e raporteve familjare me vajzën e mitur ndërsa si rrethanë rënduese gjykata nuk gjeti pos elementeve të cilat plotësojnë figurën e veprave penale, ndërsa sa i përket pretendimeve se i pandehuri është recidivist, prokuroria me asnjë vendim të formës së prerë nuk e ka argumentuar këtë pretendim, po ashtu edhe pretendimet tjera sipas vlerësimit të gjykatës kanë qenë duplifikim i elementeve të veprave penale.

Gjykata, të pandehurit i shqiptoi dënim duke e marrë për bazë minimumin dhe maksimumin dhe qëllimin e dënimit dhe duke u bazuar në rrethanat lehtësuese dhe është e bindur se edhe me një dënim të tillë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit.

Konform neneve 450 dhe 453 të KPPK-ës, u detyrua i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës (Dy ekspertiza mjeko ligjore) të paguaj shumën prej 40€, si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj pranë kësaj gjykate shumën prej 20.00€, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konform nenit 39 par 3 pika 3.1 të ligjit Ligji Nr. 05/L -036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit gjykata e obligoi të pandehurin të paguaj shumën prej 30.00 € Fondit për Kompensimin e viktimave të krimit dhe atë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të neneve 248 dhe 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Dega në Kaçanik

P.nr.02/22 datë 02.02.2022

Procesmbajtësja

Suzane Rudi

Gjyqtari

Burim Çaka

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.